



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

Mbi miratimin e

“Manual Udhezues mbi Procedurat Standarte të Operimit për Miratimin, Funkcionimin dhe Administrimin e Garancisë Globale/Gjithëpërfshirëse, Garancisë së Reduktuar dhe Përfshirimit nga Garancia në Doganën Shqiptare”

Përmbajtja:

1. Hyrje

- Qëllimi i Manualit
- Rëndësia e Garancisë Globale/Gjithëpërfshirëse, Garancisë së Reduktuar dhe Përfshirimit nga Garancia

2. Përkufizime dhe Terminologji

- Garancia Globale / Gjithëpërfshirëse
- Garancia e Reduktuar
- Përfshirimi nga Garancia
- Operatorët ekonomikë të përfshirë

3. Procedura për Miratimin e Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse

- Kriteret për aplikim
- Dokumentacioni i nevojshëm
- Hapat për miratim

4. Procedura për Miratimin e Garancisë së Reduktuar

- Kriteret për aplikim
 - Dokumentacioni i nevojshëm
 - Hapat për miratim
- 5. Procedura për Përjashtimin nga Garancia**
- Kriteret për përjashtim
 - Dokumentacioni dhe procedura
- 6. Funksionimi i Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse, Garancisë së Reduktuar dhe Përjashtimit nga Garancia**
- Procedurat e zbatimit
 - Rregullat e përdorimit
 - Periudha e vlefshmërisë dhe rinovimi
- 7. Administrimi i Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse dhe të Reduktuar**
- Monitorimi i garancive aktive
 - Shpenzimi dhe shlyerja e garancisë
 - Rregullat për përjashtimin nga garancia
- 8. Kontrole dhe Verifikime**
- Kontrolli i dokumenteve dhe garancive
 - Kontrolli fizik i ngarkesave dhe mallrave
 - Masat disiplinore në rast shkeljesh
- 9. Përfundime dhe Rekomandime**

1. Hyrje

Qëllimi i Manualit: Ky manual ka për qëllim të përshkruajë procedurat standarte të operimit për miratimin, funksionimin dhe administrimin e Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse, Garancisë së Reduktuar dhe Përjashtimit nga Garancia në Doganën Shqiptare. Ai ofron udhëzime për operatorët ekonomikë që dëshirojnë të përfitojnë nga këto mundësi dhe siguron që proceset të jenë të qarta dhe të përcaktuara.

Rëndësia e Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse, Garancisë së Reduktuar dhe Përjashtimit nga Garancia: Garancia Globale/ Gjithëpërfshirëse ofron mundësi për menaxhimin dhe

mbikqyrjen e procedurave doganore. Garancia e Reduktuar dhe Përjashtimi nga Garancia janë mundësi që lejojnë uljen e kostove dhe thjeshtimin e proceseve për operatorët ekonomikë që përmbushin kushte të caktuara.

2. Përkufizime dhe Terminologji

- **Garancia Globale/Gjithëpërfshirëse:** Një garanci që ofrohet për të mbuluar të gjitha detyrimet doganore, që i korrespondojnë borxhit doganor në lidhje me dy ose më shumë operacione, deklarata dhe regjime doganore, të një operatori ekonomik për periudhën e caktuar, duke lejuar operacione të shumta pa kërkuar mbulim të veçantë për secilin prej tyre.
- **Garancia e Reduktuar:** Një formë e garancisë që zvogëlon shumën që duhet të ofrohet nga operatori ekonomik, bazuar në një vlerësim të rrezikut të ulët dhe historinë e mirë të pagesave doganore të operatorit ekonomik.
- **Përjashtimi nga Garancia:** Mundësia që të përjashtohen nga kërkesa për garanci në rast se operatori ekonomik plotëson kushte të veçanta, si p.sh., shlyerja e detyrimeve të mëparshme doganore dhe vlerësimi i mirë i riskut.
- **Operatorët ekonomikë të përfshirë:** Kompanitë, individët dhe entitetet që operojnë me Doganën Shqiptare dhe që kërkojnë të përfitojnë një nga llojet e garancive.

3. Procedura për Miratimin e Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse

1. Kriteret për aplikim:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë aktivitet të regjistruar aktiv në sistemin informatik të Doganës Shqiptare.
- Të ketë histori të pastër në pagesat doganore dhe të jetë përdorues i rregullt i regjimeve doganore ku ata përfshihen ose operatorë të ambienteve të Magazinimit të Përkohshëm.
- Të demonstrojë një nivel të mjaftueshëm të likuiditetit financiar dhe besueshmërie. Pra, të ketë aftësi paguese që do të kërkohen për të provuar nëse aplikuesi ka gjendje të mirë financiare, e cila i lejon atij të përmbushë angazhimet që rrjedhin e lidhen me karakteristikat e llojit të aktivitetit në fjalë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shkronjën “ç”, të nenit 41 të Kodit Doganor.
- *Për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, këto kritere konsiderohen të plotësuara.*

2. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Formulari i aplikimit për garancinë.
- Raportet financiare dhe bilanci i kompanisë.
- Dokumentacioni ligjor i regjistrimit të shoqërisë.
- Raport periodik vjetor mbi veprimet në doganë dhe pagimit të detyrimeve doganore.
- Forma e garancisë në bazë të neneve 87-89 të Kodit Doganor.

3. Hapat për miratim:

- Dorëzimi i kërkesës dhe dokumenteve përkatëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Vlerësimi i kërkesës nga autoritetet doganore. *Për këtë, struktura që mbulon çështjet e Garancive Doganore bashkëpunon me Sektorin e Lehtësimeve Doganore për shqyrtimin e dokumentacionit që lidhet me kriteret e aftësisë paguese dhe Sektorin e Monitorimit dhe Analizës së Riskut lidhur me kriteret e besueshmërisë për vlerësimin e riskut.*
- Njoftimi i operatorit ekonomik për miratimin ose refuzimin e garancisë.
- Lëshimi i Çertifikatës për miratimin e Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse dhe përcaktimi i kushteve të përdorimit (sipas Aneksit 1 bashkëlidhur).

4. Procedura për Miratimin e Garancisë së Reduktuar

1. Kriteret për aplikim:

- Operatori ekonomik duhet të ketë një histori shumë të mirë të pagesave doganore dhe të mos ketë shkelje të rregullave doganore për 3 vite nga përdorimi i Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse.
- Të ketë një profil të riskut të ulët sipas vlerësimit të Degës së Doganës Mbikëqyrëse dhe Sektorit të Monitorimit dhe Analizës së Riskut në DPD.
- *Për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, këto kritere konsiderohen të plotësuara.*

2. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Formulari i aplikimit për garancinë e reduktuar.
- Raportet financiare dhe pasqyrat e aktiviteteve të mjaftueshme.

- Dokumentacioni ligjor i regjistrimit të shoqërisë.
- Raport periodik vjetor mbi veprimet në doganë dhe pagimit të detyrimeve doganore.
- Forma e garancisë në bazë të neneve 87-89 të Kodit Doganor.

3. Hapat për miratim:

- Dorëzimi i dokumenteve pranë Doganës.
- Vlerësimi i kushteve dhe përcaktimi i shumës së garancisë së reduktuar. Garancia mund të reduktohet në masën 30%, 50% ose 70%.
- Njoftimi për miratimin ose refuzimin e garancisë.
- Lëshimi i Çertifikatës për miratimin e Garancisë Globale të Reduktuar dhe përcaktimi i kushteve të përdorimit.

5. Procedura për Përrjashtimin nga Garancia

1. Kriteret për përjashtim:

- Operatori ekonomik duhet të ketë një histori shumë të mirë të pagesave doganore dhe të mos ketë shkelje të rregullave doganore për 3 vite nga përdorimi i Garancisë së Reduktuar.
- Të ketë një profil të ulët të riskut sipas vlerësimit të Degës së Doganës Mbikëqyrëse dhe Sektorit të Monitorimit dhe Analizës së Riskut në DPD.
- *Për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, këto kritere konsiderohen të plotësuar.*
Përrjashtimi mund të aplikohet për një periudhë të caktuar kohore.

2. Dokumentacioni dhe procedura:

- Kërkesa për përjashtim dhe dokumente mbështetëse që vërtetojnë përmbushjen e kushteve.
- Vlerësimi i kërkesës dhe pasqyrimi i të dhënave.
- Miratimi i përjashtimit dhe përrfundimi i procesit me njoftim për operatorin ekonomik.
- Lëshimi i Çertifikatës për miratimin e Garancisë Globale me Përrjashtim dhe përrcaktimi i kushteve të përrdorimit.

6. Funksionimi i Garancisë Globale/Gjithëpërfshirëse, Garancisë së Reduktuar dhe Përrjashtimit nga Garancia

1. Procedurat e zbatimit:

- Garancia Globale/Gjithëpërfshirëse mund të përdoret për dy ose më shumë operacione apo regjime doganore.
- Garancia e Reduktuar lejon një mbulim më të vogël/të ulët për detyrimet doganore duke ulur koston për operatorin ekonomik.
- Përrjashtimi nga garancia lejon ndihmën për ata operatorë ekonomikë që kanë treguar besueshmëri të lartë në zbatimin e rregullave dhe procedurave doganore.

2. Rregullat e përdorimit:

- Garancia është e vlefshme për periudhën e caktuar dhe mund të përdoret për çdo operacion doganor që përmbush kërkesat e Administratës Doganore.
- Operatorët ekonomikë duhet të respektojnë legjislacionin doganor dhe të gjitha rregullat doganore për të shmangur shfuqizimin e garancisë ose përrjashtimit.

3. Periudha e vlefshmërisë dhe rinovimi:

- Garancia ka një periudhë të caktuar vlefshmërie që mund të rinovohet nëse kërkohet.

7. Administrimi i Garancisë Globale/ Gjithëpërfshirëse dhe të Reduktuar

1. Regjistrimi i garancisë në sistem

- Regjistrimi i garancisë në sistem kushtëzohet nga depozitimi i aneksit 32-03 i shtojcës B të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor (në rastet e përdorimit të formës së garancisë “me dorëzani”), të nënshkuar nga dorëzani (banka/ shoqëria e sigurimit/ institucioni financiar) që e lëshon.

2. Monitorimi i garancive aktive:

- Dogana monitoron në vazhdimësi garancitë aktive dhe përdorimin e tyre për të siguruar përputhshmërinë me rregullat.

3. Përdorimi dhe shlyerja e garancisë:

- Garancia mund të përdoret vetëm për pagesat e detyrimeve doganore ose shlyerjen e borxhit që ka lindur si pasojë e operacioneve të mbuluara nga kjo garanci.

4. Rregullat për përrjashtimin nga garancia:

- Përjashtimi nga garancia mund të aplikohet vetëm pas vlerësimit të riskut dhe mund të rishikohet periodikisht.

8. Kontrollle dhe Verifikime

1. Kontrolli i dokumenteve dhe garancive:

- Autoritetet Doganore kanë të drejtë të kontrollojnë çdo dokument që ka lidhje me garancinë e dhënë dhe mund të kërkojnë sqarime të mëtejshme.

2. Kontrolli fizik i ngarkesave dhe mallrave:

- Kontrolllohet fizike, mbi mallrat dhe ngarkesat e vendosura nën regjimet doganore të mbuluara me garanci, kryhen për të siguruar që mallrat (lloji dhe sasia e tyre) përputhen me dokumentacionin dhe rregullat doganore.

3. Masat disiplinore në rast shkeljesh:

- Shkeljet e procedurave mund të sjellin krahas heqjes/shfuqizimit të garancisë edhe sanksione financiare ose masa të tjera ligjore.
- Në rastet e shfuqizimit të statusit OEA garancia gjithëpërfshirëse e përfituar shfuqizohet automatikisht.

9. Përfundime dhe Rekomandime

Ky manual ka për qëllim të ofrojë një kuptim të plotë të procesit të administrimit të Garancisë Globale, Garancisë së Reduktuar dhe Përjashtimit nga Garancia në Doganën Shqiptare. Operatorët ekonomikë duhet të sigurohen që ndjekin çdo procedurë dhe të respektojnë rregullat për të përfituar nga këto mundësi si dhe për të shmangur komplikimet ligjore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja